

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9975, DATË 28.7.2008, “PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Propozimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”, është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe është pjesë e Paketës Fiskale 2019.

- Ky projektligj ka për qëllim të rishikojë skemën e taksimit të ambalazheve të plastikës dhe të qelqit si dhe propozon rritjen e rentës për eksportin e mineralit të kromit të papërpunuar.
- Për plastikën, ndryshimi synon uljen e nivelit të taksës me 2/3 dhe zgjerimin e bazës së saj me produktet e tjera të plastikës. (Produktet që përfshihen në Kodin 39 të NKM).
- Për ambalazhet e qelqit, projektligji synon uljen e nivelit të saj, me qëllim uljen e kostove të prodhimit të produkteve.
- Për prodhimin brenda vendit, propozohet vendosja e taksës mbi lëndët primare të importuara dhe që përdoren për prodhimin e mallrave plastike, përfshirë ambalazhin.
- Projektligji parashikon rritjen e nivelit të rentës minerare për mineralin e kromit që eksportohet. Në dokumentin “Strategjia minerare e Republikës së Shqipërisë 2010-2025”, sasia e përgjithshme e rezervave të njohura të nxjerrshme të kromit në vitin 2010 vlerësohej në 10 milion ton. Në këtë dokument theksohet që kromi duhet të shkojë drejt përpunimit, duke ulur eksportin si mineral dhe duke rritur eksportin e kromit të përpunuar si ferrokrom. Për këtë qëllim, duhet të ndërmerren politika që të stimulojnë përpunimin e mineralit në vend dhe rritjen e vlerës së tij për eksport. Një ndër mënyrat mund të jetë rritja e rentës minerare për të dekurajuar eksportin të mineralit të kromit të papërpunuar.
- Incentivim e eksporteve duke hequr taksën e karbonit për benzinën dhe gazoilin që eksportohet.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është parashikuar në programin analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Strukturat e Bashkimit Evropian kanë kritikuar diferencimin ndërmjet taksës së ambalazheve plastike, që importohen, dhe atyre që prodhohen në vend nga riciklimi. Ndryshimi është 1:100. Taksa e ambalazheve plastike është 100 lekë/kg dhe zbatohet si në import, ashtu edhe në prodhimin vendas. Taksa e ambalazheve plastike për ambalazhet e prodhuara nga industria vendase e riciklimit të mbetjeve plastike është 1 lekë/kg.

Industria vendase e prodhimeve ushqimore ka ngritur në dy vitet e fundit shqetësimin për konkurrencën e pandershme në lidhje me pagimin e kësaj takse, kryesisht nga prodhuesit vendas, si dhe ka propozuar rishikimin e saj me arsyetimin se taksa e ambalazhit plastik në importin e tij paguhet e plotë, ndërkohë që prodhuesit vendas deklarojnë sasi minimale prodhimi të ambalazhit plastik që ka taksë 100 lekë/kg, dhe deklarojnë lëndë e parë plastike “jo ambalazh”, që nuk ngarkohet me këtë taksë. Duke pasur parasysh se psh. në industrinë e prodhimit të ujit, ambalazhi plastik përbën 51 % të kostos, prodhimi i ujit nga operatorë të cilët furnizohen me ambalazh plastik nga prodhues vendas që nuk e raportojnë si të tillë dhe nuk paguajnë taksën për të, krijon konkurrencë jo të ndershme dhe informalitet në këtë sektor.

Sipas të dhënave statistikore, vetëm 9-10 % e taksës nga ambalazhi plastik arkëtohet nga prodhimi vendas, ndërkohë që 90-91 % e taksës nga ambalazhi plastik arkëtohet nga importi. Bazuar në importin e lëndës së parë primare-granulat, dhe prodhimin të raportuar nga operatorët vendas, vlera mesatare e taksës së paguar është 5-7 lekë/kg, prodhim, nga 100 lekë/kg që është niveli i taksës për prodhim ambalazhi. Kjo do të thotë se pjesa dërrmuese e prodhimit raportohet si produkt që nuk i nënështrohet taksës.

Me anë të këtij projektligji propozohet që niveli i ri i taksës, që do të aplikohet mbi produktet e plastikës, të jetë 35 lekë, pra sa 1/3 e nivelit ekzistues prej 100 lekë/kg.

Gjithashtu, përveç kapitullit 39, kjo taksë do të vijojë të zbatohet edhe kur materiali plastik zë, të paktën, 51 për qind të masës së përgjithshme të

ambalazhit që ambalazhon produkte të tjera të klasifikuara në kapitujt, krerët, nënkrerët dhe kodet e tjera tarifore të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

Për prodhimin brenda vendit të materialeve plastike, propozohet të vendoset taksa mbi lëndët e para në formë primare që importohen dhe përdoren për prodhimin e mallrave plastike, përfshirë ambalazhin. Qëllimi është që të mos taksohet thjesht ambalazhi, por materiali, qoftë ambalazh, qoftë produkt tjetër plastik, pasi kanë ndikim mbi ambientin. Niveli i propozuar i taksës është 25 lekë/kg, pra më i ulët se niveli i importit të produkteve të plastikës, marrë parasysh edhe përpunimin teknologjik dhe firot që do të ketë lënda e parë gjatë shndërrimit në produkte të gatshme.

Nëpërmjet këtij ndryshimi, shfuqizojmë edhe taksën simbolike 1 lekë/kg për ambalazhet e prodhuara nga riciklimi, duke përmbushur në këtë mënyrë edhe kërkesën e strukturave të BE-së, që e shihnin këtë diferencë 1:100, në kuadrin e diskriminimit të importeve. Ndërkohë, për materialet plastike që riciklohen, është marrë taksa në momentin kur ato janë importuar.

- Për sa i përket eksportit të kromit vendi ynë eksporton në një vit:

- a) 500 mijë ton mineral kromi;
- b) 135 mijë ton eksportohet i përpunuar si ferrokrom (50 mijë ton ferrokrom).

Vlera e shtuar brenda vendit rritet nga përpunimi i ferrokromit. Nëse vlera e 135 mijë ton krom që është përpunuar me çmimet e vitit 2017 ka qenë 3 miliard lekë, vlera e 50 mijë ton ferrokrom të prodhuar dhe eksportuar ka qenë 10,2 miliard lekë, pra 3,4 herë më i lartë. Nëse marrim në konsideratë prodhimin dhe eksportin e kromit në periudhën 2011-2017, rezervat e njohura të mbetura të kromit llogariten në rreth 5,5 milion ton. Nëse do të vazhdohet me të njëjtin nivel të eksportit të mineralit të kromit (500 mijë ton në vit) dhe i njëjti nivel mineral kromi që shkon për prodhimin e ferrokromit nga industria vendase (135 mijë ton krom me të cilin prodhohet 50 mijë ton ferrokrom) rezervat e njohura të kromit në Shqipëri do të kishin jetëgjatësi rreth 8 vjet. Pra nëse rezervat e njohura të kromit shfrytëzohen me një intensitet të tillë duke eksportuar pjesën dërmuese të tij në formë të papërpunuar, industria e ferrokromit në Shqipëri duhet të mbyllet brenda një 10 vjeçari.

Për këtë qëllim, është e nevojshme të ndërmerren politika që të stimulojnë përpunimin e mineralit në vend dhe rritjen e vlerës së tij për eksport. Një ndër mënyrat është rritja e rentës minerare për të dekurajuar eksportin e mineralit krom të papërpunuar.

Ndërkohë, propozohet heqja e taksës së karbonit për sasitë e benzinës dhe gazoilit që eksportohen. Taksa e karbonit, sipas standardeve ndërkombëtare aplikohet për të detyruar përdoruesit e lëndëve djegëse që të paguajnë për dëmet që i shkaktojnë ajrit nëpërmjet çlirimit të dioksidit të karbonit në atmosferë dhe gjithashtu për të motivuar përdorimin e energjisë së pastër.

Aktualisht prodhimi shqiptar nuk është i konkurrueshëm pasi paguan taksë 2 herë, një herë në Shqipëri në momentin e eksportit dhe herën e dytë në vendin destinacion. Pra, për të njëjtin produkt kemi një taksim të dyfishtë. Po e njëjta logjikë është ndjekur edhe për taksën e qarkullimit për benzinën dhe gazoilin, e cila aktualisht nuk aplikohet për sasitë që eksportohen.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83 pika 1, dhe 155 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 7 nene:

Neni 1 i projektligjit propozon ndryshime në nenin 3, “Llojet e Taksave Kombëtare”, duke riformuluar pikat 8 dhe 8/1, si vijon:

“8. Taksa e materialeve/artikujve plastike dhe e ambalazheve prej plastike/qelqi”.

“8/1. Material/artikuj plastike konsiderohen mallrat e importuara sipas Kapitullit 39 të NKM”.

Gjithashtu, pas pikës 8/1 shtohet pika 8/2 me këtë përmbajtje:

“8/2. Ambalazh plastik/qelqi, është çdo material paketues, që shërben për paketimin e produkteve, i cili mund ta mbulojë tërësisht ose pjesërisht atë,

dhe e mbron produktin nga ndotja, infeksionet, nga ndikimet që ulin cilësinë dhe/ose vlerën e tij, dhe që e bëjnë të përshtatshëm për transport, tregtim e përdorim. Një ambalazh mund të përmbajë disa njësi ose tipa ambalazhesh”.

Neni 2 i projektligjit propozon ndryshime në nenin 4, “Niveli i Taksave Kombëtare”, si vijon:

- Në pikën “4” në paragrafin e parë dhe në paragrafin e tretë, fjalët “...në masën sa 1/2 e normës së rentës...”, zëvendësohet me “në masën sa 1/3 e normës së rentës”.

Në fund të pikës “6” shtohet fjalia:

“Për benzinën dhe gazoilin, kjo taksë nuk paguhet për sasitë që eksportohen”.

- Pika “8” ndryshon, me këtë përmbajtje:

“8. Taksa e materialeve/artikujve plastike dhe e ambalazheve plastike të importuara në Kapitullin 39 të NKM, është 35 lekë/kg, me përjashtim të lëndëve të para në formë primare të importuara në krerët “3901”, deri “3914” të NKM”.

Gjithashtu, përveç kapitullit 39, kjo taksë zbatohet edhe kur materiali plastik zë, të paktën, 51 për qind të masës së përgjithshme të ambalazhit që ambalazhon produkte të tjera të importuara, të klasifikuara në kapitujt, krerët, nënkrerët dhe kodet e tjera tarifore të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

8.1 Taksa e lëndëve të para në formë primare të importuara në Krerët “3901” deri “3914” të NKM-së, dhe që përdoret për prodhimin në vend të produkteve të plastikës, është 25 lekë/kg”.

8.2 Taksa e ambalazheve të qelqit është 5 lekë/kg dhe zbatohet për ambalazhet e qelqit të importuara dhe të prodhuara në vend. Taksa zbatohet për të gjithë artikujt prej qelqi sipas Kreut 7010 të NKM-së, në rast se ambalazhi importohet veçmas, si dhe kur materiali i qelqit zë, të paktën, 80 për qind të masës së përgjithshme të ambalazhit që ambalazhon produkte të tjera të klasifikuara në kapitujt, krerët, nënkrerët dhe kodet e tjera tarifore të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave”.

8.3 Në rastin e importit, taksa e: materialeve/artikujve plastike; lëndëve të para në formë primare për prodhimin e materialeve plastike, si dhe e ambalazheve prej plastike/qelqi llogaritet dhe mblidhet nga Administrata Doganore në momentin e importit”.

8.4 Në rastin e prodhimit brenda vendit, taksa e ambalazheve prej qelqi, mbledhet nga Administrata Tatimore sipas afateve dhe procedurave të deklarimit në këtë ligj. Administrata Tatimore monitoron dhe kontrollon lëndët e para që përdoren për prodhimin e ambalazheve të qelqit, si dhe lëndët e para në formë primare të importuara me qëllim prodhimin e materialeve dhe ambalazheve plastike brenda vendit.”.

Neni 3 i projektligjit propozon riformulimin e paragrafit të parë të shkronjës “ë” në nenin 5 “Agjentët e taksave” me këtë përmbajtje:

“ë) për taksën e materialeve/artikujve plastike dhe taksën e ambalazheve prej plastike/qelqi”:

- i) Administrata Doganore në rastet e importit të materialeve plastike, ambalazheve prej plastike/qelqi”;
- ii) Administrata Tatimore në rastet e prodhimit brenda vendit të ambalazheve prej qelqi”.

Neni 4 i projektligjit propozon riformulimin e shkronjës “e” në nenin 8 “Komisionet që përfitojnë agjentët e taksave”, me këtë përmbajtje:

“e) për taksën e materialeve/artikujve plastike dhe ambalazheve prej plastike/qelqi, 0 për qind”.

Neni 5 i projektligjit propozon ndryshime në nenin 9 “Përjashtimet nga pagimi i Taksave Kombëtare”, si vijon:

- 1. Në pikën 1/1 pas togfjalëshit *”Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”*, shtohet togfjalëshi, *“... ose në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit ..”*.
- 2. Në pikën 4, bëhen ndryshimet si vijon:

a) Fjala e parë riformulohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“4.Përjashtohen nga pagimi i taksës së materialeve/artikujve plastike dhe ambalazheve prej plastike/qelqi, sipas nenit 4”.

b) Në shkronjën “ç” hiqen nënpikat “i”, “ii”, “iii”, “iv”, “vi”, “vii”.

- 3. Në pikën 7, në shkronjën “ç”, pas togfjalëshit *”Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”*, shtohet togfjalëshi, *“... ose në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit ..”*.

Neni 6 i projektligjit propozon që përqindja e rentës minerare nga 6 për qind, të bëhet 9%, për “Mineralet e kromit për eksport”, pjesë e grupit të parë (I) “Mineralet metalike”, të shtojcës nr.2, “Renta minerare sipas klasifikimit”.

Neni 7 i projektligjit parashikon që ky ligj botohet në “Fletoren zyrtare” dhe hyn në fuqi më 1 janar 2019.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI

Për zbatimin e këtij akti ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Administrata Doganore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka draftuar projektligjin. Ky projektligj është bashkërenduar me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektligji do të sjellë efekt pozitiv prej afërsisht 500 (pesëqind) milionë lekë.

KËSHILLI I MINISTRAVE